



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1701/12 prot.

Datë 13.08.2025

V E N D I M
Nr.1049/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.08.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.961/2025, datë 28.07.2025, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik "Filara" SHPK, me Nipt. K51611099N Adresa: Rr. Kavajës, Ish kombinati Misto Mame.

Autoriteti Kontraktor: ECO Tirana Sh.A. Adresa: Rr. Don Bosko, ish parku, Nj. Bashkiake 9, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 28.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 961/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Filara" SHPK në procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik "Filara" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Filara" SHPK

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 85/21 prot., datë 05.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1701/09 prot., datë 07.08.2025, autoriteti kontraktor Eco Tirana SHA, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 961/2025, datë 28.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 85/21 prot., datë 05.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1701/09 prot., datë 07.08.2025, autoriteti kontraktor Eco Tirana SHA, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 961/2025, datë 28.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, konkretisht raportit të auditit, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka bërë rivlersimin e procedurës në sistem mbi zbatimin e vendimit nr. 961/2025, datë 28.07.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A ka zbatuar vendimin nr. 961/2025, datë 28.07.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi pasi ka rivlerësuar procedurën e prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në përputhje me konstatimet e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar", me Nr. REF-48863-05-23-2025, me objekt: "Blerje adezive për kazane dhe kamionë" me fond limit 2,320,000.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.06.2025, nga autoriteti kontraktor ECO Tirana Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

